VENDIM
Nr.980, datë 1.12.2010

PËR SHPRONËSIMIN SHTESË, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LUSHNJË-FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin shtesë për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Lushnjë-Fier.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 1 725 (një mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) m^2, tokë arë, me vlerë 2 070 000 (dy milionë e shtatëdhjetë mijë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 2 070 000 (dy milionë e shtatëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

6. Shpronësimi të fillojë më 15.12.2010 dhe të përfundojë më 15.3.2011.

7. Pronari i përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilin është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarit, për të cilin është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", në përputhje me dokumentacionin e pronësisë.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Kalimi i pronësisë në favor të shtetit të bëhet jo vetëm për pasurinë e pasqyruar në listën bashkëlidhur këtij vendimi, por edhe për pasuritë e shpronësuara me të gjitha vendimet e Këshillit të Ministrave, që kanë miratuar shpronësimet, përgjatë segmentit rrugor Lushnjë-Fier, për të cilat do të bashkëpunohet me zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Fier dhe Lushnjë.

11. Zyra e Qendrore Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Fier dhe Lushnjë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Fier dhe Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARIT QË SHPRONËSOHET NË SEGMENTIN RRUGOR LUSHNJË-FIER

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr.Pas.	Tokë arë			Shënime
						Sip. m^2	Çmimi Lekë/m^2	Vlera lekë	
1	Luis	Dervish	Veliu	2636	72/36	1725	1200	2 070 000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
		Totali				**1725**		**2 070 000**	